



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.72

18 qershor

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr.24, datë 13.6.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.161/1, datë 14.9.2004 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për marrjen e masës disiplinore “vërejtje” ndaj gjyqtarit Vladimir Skënderi”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	2139
Vendim i GJK nr.25, datë 13.6.2007	Me objekt: 1. Shfuqizimin e vendimeve nr.175/2, datë 28.4.2005 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.6, datë 8.3.2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën. 2. Shfuqizimin e nenit 42/5 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.”, si të papajtueshëm me Kushtetutën.....	2141
Vendim i GJK nr.26, datë 13.6.2007	Me objekt: 1. Shfuqizimin e vendimit nr.6, datë 8.3.2006 të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, si të papajtueshëm me Kushtetutën. 2. Shfuqizimin e vendimit nr.172/2 datë 14.4.2005 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.....	2146

VENDIM
Nr.24, datë 13.6.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datën 3.11.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.36/6 Akti, që i përket:

KËRKUES: VLADIMIR SKËNDERI

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, përfaqësuar nga Izet Sala e Luan Dervishi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr.161/1, datë 14.9.2004 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për marrjen e masës disiplinore “vërejtje” ndaj gjyqtarit Vladimir Skënderi”.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 44 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi, duke pretenduar se është zhvilluar një proces jo i rregullt në kuptimin kushtetues, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të lartpërmendur të Këshillit të Lartë të Drejtësisë:

- Legjislatori nuk ka parashikuar afate për shlyerjen e masave disiplinore dhe si rrjedhojë, nga marrja e kësaj mase, do të kem pasoja në të ardhmen.

- Nuk janë respektuar të drejtat e mia procedurale për të m’u dhënë koha e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes.

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka shkelur parimin kushtetues të barazisë së shtetasve para ligjit sepse është favorizuar për të ndikuar në vendimmarrje Ministri i Drejtësisë. Po kështu është cenuar parimi i barazisë dhe për faktin se, për të njëjtën çështje, gjyqtarët e tjerë nuk u ndëshkuan me masë disiplinore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, kërkuesin, përfaqësuesit e subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr.161/1, datë 14.9.2004, ka marrë ndaj kërkuesit Vladimir Skënderi masën disiplinore “vërejtje” me motivacionin “kryerje të veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës”.

Kundër këtij vendimi kërkuesi është ankuar në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Këto të fundit, me vendimin nr.8, datë 8.3.2006, kanë vendosur pushimin e gjykimit të

çështjes me arsyetimin se, sipas vendimit nr.29, datë 9.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë, vetëm kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për shkarkimin nga detyra.

Ankuesi është ankuar në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar se vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.161/1, datë 14.9.2004, me të cilin i është dhënë atij masë disiplinore “vërejtje”, është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Sipas kërkesës, procesi i parregullt konsiston në mosrespektimin e të drejtave të tij, që kanë të bëjnë me mbrojtjen para dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Përpara shqyrtimit të këtyre pretendimeve Gjykata Kushtetuese duhet të shqyrtojë nëse çështja hyn në juridiksionin e saj në lidhje me objektin e kërkesës, pasi në varësi të këtij problemi ajo do të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Sipas nenit 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese zhvillon gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, por kjo e drejtë kushtëzohet me shterimin e të gjitha mjeteve të tjera juridike nga individ, përpara se të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Nga shqyrtimi i çështjes u konstatua se kërkuesi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij përderisa ai nuk i është drejtuar paraprakisht organeve të tjera shtetërore.

Me ligjin nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” (neni 34/1), gjyqtari kishte të drejtë të ankohej në Gjykatën e Lartë për masën disiplinore të dhënë ndaj tij, duke përfshirë edhe masën disiplinore të vërejtjes apo transferimit. Por, me kërkesën e Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.29, datë 9.11.2005, shfuqizoi si të papajtueshme me Kushtetutën atë pjesë të dispozitës që lejonte ankimin e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë për masat disiplinore (me përjashtim të shkarkimit nga detyra), të dhëna nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Neni 147 i Kushtetutës ka parashikuar kompetencën e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që të ndërhyjë e të marrë masa për disiplinimin e gjyqtarëve në ato aspekte që lidhen me ushtrimin e funksioneve e ruajtjen e figurës së gjyqtarit. Por, ndërsa për largimin nga detyra Kushtetuta u ka dhënë të drejtë gjyqtarëve të ankohen në Gjykatën e Lartë, për masat e tjera disiplinore nuk përcakton organin ku ata mund të ankohen dhe as mënyrën e shqyrtimit të këtyre ankesave.¹ Llojin dhe natyrën e masave disiplinore, si dhe procedurën e marrjes së tyre Kushtetuta e ka lënë në vlerësim të ligjvënësit.

Gjykata Kushtetuese, duke pranuar se “Kushtetuta nuk i ka lënë ndonjë hapësirë ligjvënësit që, në kuptim të fuqizimit të standardit të mbrojtjes së gjyqtarëve, të përfshijë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës së Lartë shqyrtimin e ankimit ndaj masave të tjera disiplinore”¹, nuk ka konsideruar si të papajtueshëm me Kushtetutën shqyrtimin nga organe gjyqësore të ankesave të gjyqtarëve për masat disiplinore, të dhëna nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

E drejta e çdo individ për t’iu drejtuar gjykatës buron nga neni 42/2 i Kushtetutës. Përsa u përket gjyqtarëve, Kushtetuta i ka deleguar ligjvënësit kompetencën që, nëpërmjet ligjit, të rregullojë në mënyrë të hollësishme çështjet që lidhen me transferimin dhe përgjegjësinë disiplinore, por pa u shprehur për të drejtën e ankimit të tyre dhe për organin që do të shqyrtojë këto ankesa. Jo vetëm kaq, por legjislacioni ynë ka parashikuar të drejtën e aksesit të një numri funksionarësh publikë nëpërmjet rrugës gjyqësore, si p.sh. nëpunësit e shërbimit civil kundër vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil, për largimin e tyre nga detyra, apo të prokurorëve për të kërkuar pagën, nëse shkarkimi i tyre nga detyra është i

¹ Vendimi nr.29, datë 9.11.2005 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

pabazuar.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut përcakton disa nga të drejtat themelore të njeriut, por ajo nuk ndalon që shtetet palë të parashikojnë edhe më shumë të drejta e liri për individët, ndërsa Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 17 të saj, e ka pranuar përmbajtjen e Konventës Europiane si minimumin e këtyre kufizimeve, pa penguar që legjislacioni vendas t'u japë më shumë të drejta e liri, si dhe një dimension më të madh realizimit të mbrojtjes së individit.

Legjislacioni shqiptar nuk ka pasqyruar ndonjë kufizim për të drejtën e gjyqtarëve për t'iu drejtuar gjykatave të sistemit gjyqësor. Përkundrazi, ai ka pranuar të drejtën e ankimit të tyre në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë edhe në rastet e masave disiplinore të dhëna nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Nëse Gjykata e Lartë ka ndalim kushtetues sepse një kompetencë e tillë nuk i është dhënë shprehimisht nga Kushtetuta, një ndalim të tillë nuk e kanë gjykatat e tjera të sistemit gjyqësor, të cilat për më tepër, në shqyrtimin e çështjeve bazohen në parimin e përcaktuar në nenin 1/2 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit ato nuk mund të refuzojnë të shqyrtojnë dhe të japin vendime për çështjet që paraqiten për shqyrtim me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.25, datë 13.6.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Alfred Karamuço	Anëtar i	"	"
Kristofor Peçi	Anëtar i	"	"
Kujtim Puto	Anëtar i	"	"
Vjollca Meçaj	Anëtar e	"	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	"	"
Sokol Sadushi	Anëtar i	"	"
Fehmi Abdiu	Anëtar i	"	"

me sekretare Brunilda Bara, në datat 3.11.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.37/7 Akti, që i përket:

KËRKUES: EDMOND GOGO, përfaqësuar nga avokat Dashamir Kore, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, përfaqësuar nga Izet Salaj e Mine Progonati, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.175/2, datë

28.4.2005 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.6, datë 8.3.2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

2. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 42/5 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.”

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131 shkronjat “a, f”; 134 shkronja “g”; 147 paragrafët 4 e 5 të Kushtetutës, si dhe nenet 27-31 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve të lartpërmendura duke pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

- Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ishin të detyruara të shqyrtonin kërkesën duke u bazuar në ligjin e kohës kur është paraqitur kërkesa. Në kundërshtim me konceptin kushtetues ajo i ka dhënë fuqi prapavepruese vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.29, datë 9.11.2005.

- Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke pushuar gjykimin e çështjes pa e dërguar atë për kompetencë në një gjykatë tjetër, kanë vepruar në kundërshtim me nenet 17 e 42 të Kushtetutës, sepse në këtë mënyrë i mohojnë gjyqtarit të drejtën e ankimit kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

- Gjykata e Lartë ishte e detyruar të shqyrtonte thelbin e masës së marrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për të konstatuar se në të vërtetë ndodhemi para largimit nga puna, pasi transferimi nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë është bërë në kundërshtim me kërkesat të nenit 147 pikat 4 e 5 të Kushtetutës.

- Baza ligjore ku e mbështet vendimin e saj Gjykata e Lartë është e gabuar, sepse ajo pa vend ka zbatuar nenin 485 shkronja “e” të Kodit të Procedurës Civile.

- Ligji mbi bazën e të cilit Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka marrë masën disiplinore ndaj meje është antikushtetues, sepse Kushtetuta nuk e parashikon transferimin si masë disiplinore. Ajo bën fjalë vetëm për transferimin me pëlqimin e gjyqtarit, ose si një mjet për të ndihmuar dhënien e drejtësisë, prandaj, Gjykata Kushtetuese duhet ta shfuqizojë pikën 5 të nenit 42 të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka deklaruar se:

- Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese që është i detyrueshëm si për të, ashtu dhe për organet e institucionet e tjera pjesëmarrëse në gjykim.

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk e ka larguar kërkuesin nga puna, por e ka transferuar atë konform ligjit, i cili ka parashikuar transferimin edhe si masë disiplinore.

- Ligji nuk bie ndesh me Kushtetutën, siç pretendon kërkuesi, sepse vetë neni 147 pika 4 e tij parashikon të drejtën e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të vendosur edhe për përgjegjësinë e gjyqtarëve sipas ligjit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fehmi Abdiu, përfaqësuesin e kërkuesit, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr.175/2, datë 28.4.2005, ka vendosur ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, Edmond Gogo, masën disiplinore të transferimit në një gjykatë të një niveli më të ulët, duke e caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër me motivacionin “Për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës”.

Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur kërkesë përpara Kolegjeve të Bashkuara të

Gjykatës së Lartë, duke parashtruar se ai bie ndesh me nenin 147/5 të Kushtetutës.

Gjatë shqyrtimit të një kërkesë analoge me atë të kërkuarit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë çmuar se ekziston një mospërputhje midis nenit 34/1 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dhe se zgjidhja përfundimtare e çështjes lidhet ngushtë me ligjin që kundërshtohet, prandaj, bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, ia kanë referuar çështjen Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën.

Deri në atë kohë, bazuar në nenin 34/1 të ligjit të lartpërmendur, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë pranonin për shqyrtim jo vetëm ankimet për masën e shkarkimit të gjyqtarit nga detyra, por edhe për masat e tjera disiplinore që merrte Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.29, datë 9.11.2005, ka shfuqizuar si të papajtueshme me Kushtetutën shprehjen “si dhe për çdo masë tjetër me karakter disiplinor”, të nenit 34/1 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, që parashikonte të drejtën e gjyqtarit për t’u ankuar edhe ndaj masave të tjera disiplinore në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në vendim theksohet se: “Kjo dispozitë që parashikon të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë ndaj çdo mase tjetër me karakter disiplinor, përbën një tejkalim të përmbajtjes së dispozitës Kushtetuese në dy drejtime: në aspektin e zgjerimit të masave të tjera disiplinore dhe në atë të tejkalimit të juridiksionit të Gjykatës së Lartë”.

Gjykata Kushtetuese, në këtë vendim, ka arritur në përfundimin se Gjykata e Lartë ka juridiksion të shqyrtojë vetëm vendimet që Këshilli i Lartë i Drejtësisë merr ndaj gjyqtarit për shkarkimin nga detyra (duke përjashtuar kështu juridiksionin e saj për masat e tjera disiplinore), duke u shprehur se: “Kushtetuta nuk i ka lënë ndonjë hapësirë ligjvënës, që në kuptim të fuqizimit të standardit të mbrojtjes së gjyqtarëve, të përfshijë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës së Lartë edhe shqyrtimin e ankimit ndaj masave të tjera disiplinore”.

Pasi ka hyrë në fuqi vendimi i lartpërmendur i Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Lartë ka proceduar me shqyrtimin e disa kërkesave, përfshi edhe atë të kërkuarit, për të cilën ishte vendosur pezullimi i gjyqimit të çështjes, në pritje të qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese. Në përfundim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të tyre duke arsyetuar se norma ligjore që u njihte Kolegjeve të Bashkuara juridiksion gjykimi, është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese si e papajtueshme me Kushtetutën. Në këtë mënyrë, ajo ka zbatuar direkt nenin 147/6 të Kushtetutës, sipas të cilit Kolegjet e Bashkuara gjykojnë vetëm ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që vendosin për shkarkimin e gjyqtarit nga detyra dhe jo edhe për masa të tjera disiplinore.

Gjykata Kushtetuese çmon se, për çështjen në shqyrtim, marrin rëndësi pretendimet e kërkuarit, që lidhen drejtpërsëdrejti me procesin e rregullt ligjor, konform kërkesave të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

E rëndësishme është se, për aq sa është pranuar në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur vetëm për juridiksionin e tyre, pasi nuk e kanë nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor në tërësi.

Në rrethanat në të cilat janë gjendur, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk kanë mbështetur qëndrimin e tyre bazuar në nenin 76/2, shkronja “b” të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Ato janë bazuar te vendimi konkret i Gjykatës Kushtetuese, që ka shfuqizuar dispozitën ligjore, që i lejonte ato të gjykonin edhe ankimet kundër masave disiplinore të dhëna ndaj gjyqtarëve nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Duke qenë kështu, kjo Gjykatë çmon me vend të shprehet për t'i dhënë përgjigje pretendimit të kërkuarit nëse gjyqtarët duhet të gëzojnë të drejtën të ankohen kundër vendimeve që kanë për objekt masat e tjera disiplinore ndaj tyre.

Lidhur me këtë, për çështjen në gjykim ka rëndësi fakti se kjo gjykatë, në jurisprudencën e saj, është shprehur se “e drejta e prokurorëve për t'u ankuar buron nga Kushtetuta. Kushtetuta nuk përcakton për prokurorët ndonjë procedurë të veçantë gjykimi siç bën për gjyqtarët, por nuk i përjashton ata nga e drejta për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të kundërshtuar aktet administrative sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, ashtu siç e kanë këtë të drejtë të gjithë personat e tjerë fizikë e juridikë”.¹

Duke mbajtur këtë qëndrim, Gjykata Kushtetuese ka bërë interpretimin e frymës së nenit 147/7 të saj dhe ka konkluduar se edhe gjyqtarët duhet ta gëzojnë patjetër të drejtën e ankimit kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Gjykata Kushtetuese konstaton gjithashtu se vetë 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, nuk ndalojnë edhe për gjyqtarët të drejtën për të bërë ankim në gjykatë, sepse e shohin atë të lidhur ngushtë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të njohur si një standard kushtetues bashkëkohor.

Gjithmonë në lidhje me këtë problem, një tjetër argument kushtetues është dhe fakti se, në legjislacionin shqiptar, në ligjin “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, të drejtën për t'u ankuar e për të kundërshtuar aktet administrative e kanë të gjithë punonjësit e këtij shërbimi, konform dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

Duke qenë çështja sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se gjyqtarët duhet të gëzojnë të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës e për t'u ankuar edhe kundër masave disiplinore që merr ndaj tyre Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Përsa i përket përcaktimit të gjykatës kompetente, kjo gjë nuk mund të bëhet nga kjo Gjykatë, sepse Gjykata Kushtetuese nuk mund të luajë rolin e ligjvënësit prandaj, është ky i fundit që duhet të përcaktojë organin gjyqësor kompetent ku duhet të ankohen gjyqtarët në raste të tilla.

I pambështetur për Gjykatën Kushtetuese është edhe pretendimi se është Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë organi kompetent për të gjykuar një ankim të tillë të kërkuarit. Kjo Gjykatë konstaton se neni 34/1 i ligjit nr.8656, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” është detajuar në nenin 14 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” që në mënyrë të qartë ka përcaktuar se Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara ankimet kundër masave të marra nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Këtë qëndrim mban edhe neni 46 i ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” që, duke i dhënë të drejtë gjyqtarit, të ankohet kur shkarkohet nga detyra, përcakton se gjykimi në këtë rast bëhet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

I pabazuar është edhe pretendimi i kërkuarit se qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë bie ndesh me nenin 1/2 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, “gjykata nuk mund të refuzojë, të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështje që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë”. Në çështjen në shqyrtim, gjykata nuk ka konstatuar se për rastin konkret të mungonte ndonjë ligj prandaj, nuk ka arsyetuar në lidhje me këtë aspekt. Përkundrazi, në vendimin e saj ajo ka trajtuar dhe argumentuar se nuk mund ta gjykonte këtë çështje, pasi ndodhej para një fakti me rëndësi, se Gjykata Kushtetuese kishte përcaktuar që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kishin të drejtë të shqyrtonin ankime kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve. Ato nuk kanë konstatuar asnjë mungesë në legjislacion e asnjë paqartësi në përmbajtjen e nenit 1, paragrafi i dytë, të

¹ Shih vendimin nr.38, datë 23.12.2003 të Gjykatës Kushtetuese, botime të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, viti 2003, fq.186.

Kodit të Procedurës Civile që ka të bëjë me referime për ligjin material e jo procedural.

Kërkuesi, ndër të tjera, ka kërkuar edhe shfuqizimin e nenit 42/5 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duke pretenduar se kjo dispozitë bie ndesh me përmbajtjen e nenit 147 pikat 4 e 5 të Kushtetutës, që sipas tij nuk e parashikojnë transferimin edhe si masë disiplinore. Duke pasur këtë mendim ai u ka kërkuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që të aplikojnë nenin 145/2 të Kushtetutës, të vendosnin pezullimin e gjykimit të çështjes dhe të kërkonin para kësaj Gjykate që të shprehej për papajtueshmërinë e dispozitës së lartpërmendur me Kushtetutën. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me të drejtë kanë arsyetuar se, përsa kohë nuk kanë juridiksion të gjykojnë çështjen konkrete, ato nuk mund të pezullojnë gjykimin dhe ta dërgojnë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, pasi ligji nuk është i aplikueshëm në çështjen konkrete që ka në shqyrtim.

Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese konstaton se, për aplikimin e nenit 145/2 të Kushtetutës e për ndërmarrjen e nismës për të pezulluar gjykimin e çështjes dhe dërgimin e saj për të ushtruar kontroll incidental, kërkohet ndër të tjera që gjyqtari apo gjykata duhet të jetë gjykatë kompetente, të jetë gjykatë e caktuar me ligj për gjykimin e çështjes. Pavarësisht nga sa është parashtruar më lart, në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit, Gjykata Kushtetuese është shprehur në vendimin e saj nr.21, datë 7.6.2007, me të cilin ka shfuqizuar pikën 5 të nenit 42 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, prandaj, për këtë pjesë, kërkesa e kërkuesit mbetet pa objekt.

Përsa është analizuar më lart, Gjykata Kushtetuese konstaton se qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që kanë vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës së kërkuesit, është kushtetues.

Ky qëndrim nuk ka mohuar të drejtën e gjyqtarit për të pasur akses në gjykatë kundër masave me karakter disiplinor që vendos Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.26, datë 13.6.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

Vjollca Meçaj	Anëtare e	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 2.11.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.38/8 Akti që i përket:

KËRKUESE: FIQIRETE MULLAJ, përfaqësuar nga avokate Evelina Qirjako, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, përfaqësuar nga Izet Salaj dhe Luan Dervishi, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.6, datë 8.3.2006 të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

2. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.172/2 datë 14.4.2005 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kërkuesja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime kryesore:

- Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për masën disiplinore të transferimit të gjyqtarit, nuk kanë zbatuar ligjin që vepronte në kohën e paraqitjes së kërkesës, por i kanë dhënë fuqi prapavepruese një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, duke pranuar mungesën e juridiksionit për çështje të kësaj natyre.

- Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i kanë hequr të drejtën për zhvillimin e një gjykimi të drejtë e të paanshëm në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Çështja nuk duhej shqyrtuar në Kolegjet e Bashkuara, por në kolegjet e Gjykatës së Lartë.

- Nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe mosshprehja e tyre për juridiksionin dhe kompetencën me arsyetimin se ligji mungon, i ka mohuar gjyqtarit të drejtën për t'u ankuar ndaj një vendimi të padrejtë të organeve të procedimit disiplinor.

- Transferimi i gjyqtarëve ka një rregullim kushtetues dhe nuk mund të jetë mjet i ndëshkimit disiplinor. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në kundërshtim me nenin 147, pika 4 e 5, të Kushtetutës ka vendosur transferimin e gjyqtarit në një gjykatë të një niveli më të ulët, pa pëlqimin e tij, dhe pa pasur nevoja të riorganizimit të sistemit gjyqësor. Transferimi që prek nivelin e detyrës, statusin e gjyqtarit të apelit dhe pagën, përbën në fakt një ndërprerje të marrëdhënieve të punës dhe caktim në një punë tjetër.

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka marrë masën disiplinore të transferimit në një gjykatë të një niveli tjetër mbi bazën e vlerësimeve negative të disa vendimeve të formës së prerë që ka bërë grupi i inspektorëve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesen e kërkueses, përfaqësuesit e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.172/2 datë 14.4.2005 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është marrë ndaj kërkueses Fiqirete Mullaj masa disiplinore e transferimit nga gjyqtare e Gjykatës së Apelit Tiranë, në gjyqtare të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.6, datë 8.3.2006, në referencë të vendimit nr.29, datë 9.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese, kanë pushuar gjykimin e çështjes, me arsyetimin se ankimet ndaj masave të tjera disiplinore, me përjashtim të largimit nga detyra, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës së Lartë.

Kërkuesja i ka përqendruar pretendimet për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në disa drejtime kryesore, të cilat kanë të bëjnë me ligjin e zbatueshëm në kohën e ushtrimit të ankimit ndaj masës disiplinore të transferimit, me të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate, si dhe me antikushtetutshmërinë e transferimit të gjyqtarëve si masë disiplinore.

Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e kërkueses duhen vlerësuar në drejtim të elementeve thelbësore që karakterizojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, konform kërkesave të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

1. Pretendimi se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë zbatuar ligjin që ishte në fuqi në kohën e paraqitjes së ankimit ndaj masës disiplinore të transferimit të gjyqtarit

Duke iu referuar nenit 34 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, kërkuesja është ankuar në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që ka vendosur transferimin e saj si gjyqtare nga Gjykata e Apelit Tiranë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjatë kohës që çështja ishte për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.29, datë 9.11.2005, ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dispozitën ligjore që zgjeronte juridiksionin e Gjykatës së Lartë edhe për masat e tjera disiplinore. Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur pushimin e gjykimit me argumentin e mungesës së juridiksionit për çështje të kësaj natyre.

Pretendimi i kërkueses se kjo gjykatë, padrejtësisht, i ka dhënë fuqi prapavepruese vendimit të Gjykatës Kushtetuese mbi një çështje, e cila kishte filluar në bazë të ligjit të mëparshëm, nuk është i drejtë. Fuqinë prapavepruese një vendimi të Gjykatës Kushtetuese nuk ia jep gjykata, por ligji. Sipas nenit 76, pika 2 shkronja “b”, të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, vendimi ka fuqi prapavepruese *“ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë.”*

Mbi bazën e kësaj reference ligjore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese që shfuqizonte si të papajtueshëm me Kushtetutën juridiksionin e zgjeruar të Gjykatës së Lartë për të gjitha çështjet në shqyrtim, dhe që kishin të bënin me ankimet ndaj masave të tjera disiplinore, përveç largimit nga detyra të gjyqtarit. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk mund t'i referoheshin në shqyrtimin e çështjes konkrete një ligji të shfuqizuar si antikushtetues, me argumentin se zbatonin ligjin e kohës së paraqitjes së ankimit ndaj masave të tjera disiplinore, përderisa vetë ato e kishin inicuar këtë gjykim incidental kushtetues për shfuqizimin e dispozitës së sipërpërmendur dhe, nga ana tjetër, është neni 145/2 i Kushtetutës që sanksionon detyrueshmërinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për çështje të kësaj natyre.

2. Pretendimi për të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një pjesë e pandashme e garancisë për një proces të rregullt ligjor, që sanksionohet nga neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo e drejtë nuk është absolute dhe disa kufizime të saj mund të konsiderohen në përputhje me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, nëse ato kanë qëllime të ligjshme dhe janë në përpjesëtim me synimin që duan të arrijnë. Sidoqoftë, Konventa garanton të drejta

që janë praktike, efektive dhe jo teorike dhe iluzore. Shtetet janë të lira të vendosin mbi një institucion me juridiksion apeli dhe mbi kategoritë e çështjeve që do të përfitojnë nga kjo,¹ por “një shtet i cili nuk krijon institucione të tilla duhet që, në legjislacionin e tij të brendshëm, të mirëpërcaktojë kategoritë e çështjeve, të cilat nuk do të gëzojnë të drejtën e apelit.”² Për pasojë, në respekt të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, shtetet janë të detyruara të sigurojnë për këdo një të drejtë efektive për t’iu drejtuar gjykatës.

Në lidhje me legjislacionin e brendshëm, kjo e drejtë rrjedh nga rregullimi kushtetues i nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Pra, në parim, sipas këtij rregulli kushtetues nuk privohet askush nga e drejta për t’iu drejtuar gjykatës, dhe detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të verifikojë, në çdo rast konkret, respektimin ose jo të kësaj të drejte.

Për çështjen në shqyrtim, nisur nga qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që e kanë nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit të tyre, në referencë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, kërkesja synon nëpërmjet këtij gjykimi realizimin dhe shtrirjen e kësaj të drejte edhe për masat e tjera disiplinore që merren ndaj gjyqtarëve.

Gjykata Kushtetuese çmon të domosdoshme të nënvizojë faktin se qëndrimi i mbajtur prej saj, për evidentimin e zgjerimit në mënyrë antikushtetuese dhe tej kuptimit të nenit 141 që ligjvënësi i kishte dhënë juridiksionit të Gjykatës së Lartë, nuk ka pasur për qëllim mohimin e së drejtës së gjyqtarëve për t’iu drejtuar gjykatës për masat e tjera disiplinore. Ajo është konsekuente në qëndrimin e saj lidhur me moslejimin e tejkalimit të juridiksionit kushtetues të Gjykatës së Lartë, në funksion të standardit të mbrojtjes së gjyqtarit. Për rastin konkret, Kushtetuta nuk jep hapësirë për të interpretuar në mënyrë të zgjeruar juridiksionin e Gjykatës së Lartë, por njëkohësisht as nuk e ndalon ligjvënësin, që nëpërmjet nxjerrjes së normave ligjore, të parashikojë hollësisht të gjitha elementet e domosdoshme që lidhen me rastet e përgjegjësisë disiplinore, si dhe të procedurave që duhen ndjekur.

Në nenin 147 të Kushtetutës parashikohen dy rregullime për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit, nga të cilat, në kuptim dhe të nenit 4 të saj, njëri zbatohet drejtpërsëdrejti, ndërsa tjetri të referon te zgjidhja diskrecionare e ligjvënësit. Nga mënyra e formulimit të nenit 147 pika 6, konkludohet se vetë Kushtetuta ka rregulluar çështjet që lidhen me largimin nga detyra të gjyqtarit, si dhe ka njohur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë si organin kompetent që merret me shqyrtimin e këtij ankimi.

Një formulim i ndryshëm jepet në pikën 4 të këtij neni, sipas të cilit, “Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin, si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit”. Kushtetuta, nëpërmjet kësaj dispozite referuese, e ka autorizuar ligjvënësin që mbi bazën e koncepteve dhe parimeve kushtetuese të caktojë kufijtë e hapësirës rregulluese për transferimin dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve nëpërmjet nxjerrjes së normave përkatëse juridike. Pikërisht mbi bazën e këtij interpretimi të dispozitës së sipërcituar, Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se *“lloji dhe natyra e masave disiplinore, si dhe procedura e marrjes së tyre janë brenda vullnetit të ligjvënësit, përjashtimisht masës së shkarkimit nga detyra për të cilën Kushtetuta ka parashikuar një rregullim të veçantë.”*³

Gjykata Kushtetuese i përmbahet konceptit se Kushtetuta duhet interpretuar si një “instrument i gjallë” dhe në mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe më efikas të mundshëm. Gjithashtu, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, përmes jurisprudence së saj, mëse një herë ka vënë në dukje se neni 6/1 i KEDNJ vendos mbi palët kontraktuese detyrimin për të organizuar sistemin gjyqësor në një mënyrë të tillë, që gjykatat e tyre të realizojnë parametrat e sanksionuar nga kjo dispozitë.⁴

Parimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e gjyqësorit kërkojnë gjithashtu ekzistencën

¹ Vendim “Delcourt vs. Belgjikës i datës 17.1.1970.

² Vendim nr 2002-1-001 I Gjykatës Kushtetuese të Letonisë (CODICES 2003/3).

³ Vendimi nr. 29, datë 09.11.2005 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

⁴ Shiko Salesi v. Italisë, vendim i datës 26.2.1993.

edhe të mekanizmave që garantojnë realizimin efektiv të tyre. Kriteri i aksesit në gjykatë është i përmbushur në qoftë se vendimet e autoriteteve administrative i nënshtrohen kontrollit të organit gjyqësor të pajisur me juridiksion të plotë.¹ E drejta e gjyqtarit për t'iu drejtuar një autoriteti të pavarur, i cili ka në dispozicion mjetet për të rivendosur në vend të drejtat e procesit ligjor, ose pavarësinë e vet gjyqësorit, përbën një standard për funksionimin normal të shtetit të së drejtës.

Gjykata Kushtetuese thekson se, nga njëra anë, të drejtat e njeriut nuk mund të vendosen në të njëjtin nivel mbrojtjeje me të drejtat që i përkasin një funksionari publik, por, nga ana tjetër, ajo konstaton gjithashtu se e drejta e gjyqtarit për t'iu drejtuar gjykatës për veprimet që cenojnë të drejtat dhe elemente të pavarësisë së tij, nuk mohohet nga Kushtetuta apo ligji.

Mbi bazën e kësaj analize, Gjykata Kushtetuese konkludon, se Kushtetuta nuk i njeh të drejtën Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të shqyrtojë ankimet ndaj masave të tjera disiplinore të gjyqtarëve, me përjashtim të shkarkimit nga detyra, por njëkohësisht nuk pengon të drejtën e gjyqtarëve që t'i drejtohen gjykatës për veprimet që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave, të pavarësisë ose të procesit ligjor. Prandaj, duke qenë në kushtet e një ometimi ligjor që mund të sjell dhe antikushtetutshmëri, Gjykata Kushtetuese çmon, se mbetet në vullnetin e ligjvënësit, që në përmbushje të detyrimeve kushtetuese, por dhe të jurisprudencës së saj, të garantojë në të gjitha hapësirat e nevojshme ligjore të drejtën e gjyqtarëve për t'iu drejtuar gjykatës për shqyrtimin e masave të tjera me karakter disiplinor.

3. Pretendimi për papajtueshmërinë me Kushtetutën i transferimit të gjyqtarëve si masë disiplinore

Kërkuesja ka arsyetuar se Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në kundërshtim me nenin 147 të Kushtetutës, ka aplikuar ndaj saj masën disiplinore të transferimit në një gjykatë të një niveli tjetër. Ky pretendim i kërkueses nuk merret në shqyrtim për arsye se, në kuadrin e një gjykimi tjetër të inicuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.21, datë 7.6.2007, Gjykata Kushtetuese ka vendosur shpalljen si të papajtueshme me Kushtetutën të pikës 5 të nenit 42 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Në kushte të tilla, një pretendim i tillë mbetet pa objekt, përderisa ka gjetur një zgjidhje përfundimtare me një vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese vlerëson se nuk mund të shqyrtojë as pretendimin tjetër të kërkueses për vlerësimin negativ që Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka bërë ndaj saj për vendime, të cilat kanë marrë formë të prerë. Nisur nga argumenti i sipërpërmendur mbi të drejtën e gjyqtarit për t'iu drejtuar gjykatës për masat e tjera disiplinore, Gjykata Kushtetuese çmon, se në rrethana të tilla, nuk mund të përfshihet në juridiksionin e saj shqyrtimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pa u shprehur më parë një gjykatë për ligjshmërinë e këtij vendimi.

Nisur nga kjo analizë që iu bë pretendimeve të kërkueses,

- duke pasur parasysh se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë zbatuar korrektësisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese mbi mungesën e juridiksionit të tyre për masat e tjera disiplinore, me përjashtim të largimit nga detyra të gjyqtarit;

- meqenëse gjyqtarit nuk i ndalohet shprehimisht nga Kushtetuta dhe ligji e drejta për t'iu drejtuar gjykatës për veprimet që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave, të pavarësisë ose të procesit ligjor;

- përderisa nuk është shprehur përfundimisht ndonjë gjykatë për ligjshmërinë e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që ka marrë masën disiplinore të transferimit të gjyqtarit;

Gjykata Kushtetuese konkludon se në kuptim edhe të shterimit të të gjitha mjeteve

¹ Vendimi “Albert dhe Le Compte kundër Belgjikës, i datës 10.02.1983, A.58.

ligjore që i shërbejnë mbrojtjes së të drejtave të kërkuases, kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 77, 131 shkronja “ç”; 134 pika 1 shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 54, 55, 56 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 16.6.2007
Doli nga shtypi më 18.6.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë